




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Predato Received / Delivery	30.12.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSHTIC	8696/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.795/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2674/2021 të datës 29.11.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.795/2021 të datës 10.09.2021 të parashtruar nga ankuesi _____ kundër Vendimit Ref:127/2021 të datës 27.08.2021 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 30.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.795/2021 e datës 10.09.2021 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë më datë 10.09.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4569/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref:127/2021 të datës 27.08.2021 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me pretendimin ankimor së ky vendim është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr.03/20210 për Organizmin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Rregullores Nr.01/2011 Për Organizmin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe Ligjin Nr.05/L-037 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës (tutje referuar si Këshilli) bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.09.2021 dhe 15.09.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, por që ky i fundit nuk ka ofruar përgjigje në ankesë.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes shkresës me numër protokolli 5158/2021 të datës 25.10.2022 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtën lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 29.11.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2674/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të 25.10.2021 dhe ka detyruar të njëjtin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit me A.nr.795/2021 të 10.09.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4569/2021 të datës 10.09.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin ref:127/2021 të datës 27.08.2021 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.131/2020 i datës 10.08.2020; Akt Emërimit me numër protokolli 1776 të datës 18.04.2013 për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 4605/2021 e datës 14.09.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 4618/2021 e datës 15.09.2021; Njoftimin me numër protokolli 5158/2021 i datës 25.10.2021 dhe Aktgjykimin A.nr.2674/21 i datës 29.11.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e palejuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (me tej AUV), dhe së i njëjti sipas Akt-it të emërimit me numër protokolli 1776 të datës 18.04.2013, është emëruar në pozitën e punës me titull *Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv*.

Me Vendimin Nr.131/202 të datës 10.08.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ankuesi është autorizuar që të kryej detyrat dhe përgjegjësitë e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, e të cilën pozitë e ka ushtruar deri me datë 27.08.2021, pasi që me Vendimin Ref: 127/2021 të datës 27.08.2020 është shfuqizuar Vendimi me Nr.131/2020 i datës 10.08.2020 i Kryeministrit të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon së vendimi i goditur me ankesë është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr.03/20210 për Organizmin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Rregullores Nr.01/2011 Për Organizmin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe Ligjin Nr.05/L-037 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Vendimin Ref.127/2021 të datës 27.08.2021 të Kryeministrit të Kosovës dhe të obligoj këtë të fundit që ankuesin ta kthen në pozitën e punës sipas Vendimit me Nr.131/2020 të datës 10.08.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e



ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, Kolegji vlerëson se me vendimin e kundërshtuar me ankesë gjegjësisht me Vendimin Ref.127/2021 të datës 27.08.2021 të Kryeministrit të Kosovës, me të cilin është shfuqizuar Vendimi Nr.131/2020 i datës 10.08.2020 i Kryeministrit të Kosovës, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik specifik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës. Rrjedhimisht, ankuesi sipas Vendimit Nr.131/2020 të datës 10.08.2020 të Kryeministrit të Kosovës ka qenë i autorizuar që përkohësisht të ushtrojë detyrat e Kryeshefit Ekzekutiv të AUV-it, kështu që shfuqizimi i këtij vendimi nuk ka prodhuar ndonjë pasojë juridike përkitazi me marrëdhënien e punës së ankuesit sipas Aktit të Përhershëm të Emërimit me numër protokoll 1776 të datës 18.04.2013, andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave Kolegji konstaton së ankuesi nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative dhe si rrjedhojë Kolegji vlerëson së ankesa e ankuesit me numër A.nr.795/2021 e datës 10.09.2021 është e papranueshme.

Theksuar si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: K e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.795/2021

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesia
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.